

FORD ECOSPORT



Me dizajnin elegant, teknologjitë e integruar mbresëlënëse dhe zgjedhjen e motorëve ekonomikë, **"Ford EcoSport"** ofron gjithçka që ju nevojitet për një përvojë dinamike në drejtim.


NJË "ECOSPORT"

Për një ndjesi më të fortë aventure, **"Active"** i plotëson të gjitha kriteret. Stili rezistent i frymëzuar nga SUV-të dhe pozicioni i ngritur i drejtimit i japin këtij modeli personalitetin e tij të fortë.

Lart: "EcoSport" me ekran me prekje me ngjyra 8" (20,32 cm); Poshtë: "EcoSport Active" në ngjyrë metalike trupi "Luxe Yellow" (opsionale).



PRAKTICITET



AVENTURË



MODELET LUKSOZE

Materialet e cilësisë së lartë dhe teknologjitë shtesë i japin **"Titanium"** nivele më të larta sofistikimi dhe komoditeti, çka plotësohet nga elementet e stilit unik dhe fokusi te detajet.

PËR JU

Detajet estetike tërheqëse të një automjeti të linjës së performancës e bëjnë **"ST-Line"** të bjerë në sy, ndërsa pjesa e brendshme e frymëzuar nga sportet dhe marka unike "ST-Line" theksojnë karakterin e saj të dallues.



PERFORMANCË

Lart: "EcoSport Titanium" me pjesën e përparme të sediljeve "Groove" në "Ebony Black" dhe zbukurime të sediljeve pjesërisht me "Sensico"® dhe "Salerno Sensico"® në "Ebony Black" (standarde); Poshtë: "EcoSport ST-Line" me levën e marsheve të mbështjellë me "Sensico"® të cilësisë së lartë me tegela "Red" dhe timon me "Sensico"® të cilësisë së lartë me tegela të "Red" (standarde).

MËNYRA E THJESHTË PËR TË DREJTUAR NJË "FORD ECOSPORT" TË RI

- 1 EKSPLORONI
- 2 ZGJIDHNI
- 3 PERSONALIZONI
- 4 SPECIFIKIMET

Tregohet "EcoSport Active" me një ngjyrë metalike trupi "Luxe Yellow" (opsion) dhe çati me kontrast në ngjyrë "Agate Black".



1 EKSPLORONI

ECOSPORT ACTIVE

Me stilin rezistent të pjesës së jashtme të frymëzuar nga SUV-të, lustrimet dalluese të pjesës së brendshme dhe teknologjitë e avancuara, "EcoSport Active" është projektuar që t'ju ndihmojë të dilni nga rutina.

Duke shkrië në mënyrë të përsosur formën me funksionin, ajo ofron një kombinim të fortë, por të sofistikuar. E dallueshme nga çatia e veçantë dhe kapakët e pasqyrave "Agate Black", pllakat mbrojtëse të përparme dhe të pasme, harqet më të gjera të rrotave me disqe aliazhi ekskluzive 17" 5-shkallëshe "Shadow Black" dhe grilë të përparme me rrjetë, "EcoSport Active" është e krijuar për qytet dhe e ndërtuar për aventurë.

Tregohet "EcoSport Active" me një ngjyrë metalike trupi "Luxe Yellow" (opsion) dhe çatë me kontrast në ngjyrë "Agate Black".





Tregohet "EcoSport Active" me një ngjyrë metalike trupi "Luxe Yellow" (opsion) dhe çati me kontrast në ngjyrë "Agate Black".



1 EKSPLORONI

VENDI PERFEKT PËR TË QËNDRUAR

Pjesa e brendshme e sofistikuar e "EcoSport" ju rrethon me dizajnin tërheqës, materialet e punuara mrekullisht dhe veçoritë luksoze të komoditetit. Ndërsa lë në kontrollin tuaj një sërë teknologjish të avancuara, si p.sh. kontrolli elektronik automatik i temperaturës (EATC), sistemi i informimit për pikat e vdekura të shikimit, fenerët automatikë, plus kontrolli zanor* dhe navigimi i disponueshëm "SYNC 3", të cilat kujdesen për të gjitha detajet e vogla në mënyrë që të përqendroheni te kënaqësia e drejtimit.

- **Navigimi "SYNC 3"** Ju lejon të kontrolloni muzikën, navigimin, telefonatat dhe mesazhet me tekst duke përdorur vetëm zërin tuaj*. (Standard)
- **Fenerët automatikë** janë projektuar për të diktuar nivelet në rënie të dritës natyrore dhe për të aktivizuar fenerët për ju. (Standard në "Titanium", "ST-Line" dhe "Active")



Timon me ngrohje

Me aktivizim të thjeshtë me shtypjen e një butoni, timoni me ngrohje i "EcoSport" shton një shtresë tjetër komoditeti midis jush dhe të ftohtit jashtë. (Opsion)

Automjeti i treguar përfshin pjesë shtesë që disponohen me çmim shtesë.

*Mos e drejtoni automjetin kur jeni të shpërqendruar. Përdorni sisteme operimi zanore kur është e mundur; mos përdorni pajisje dore gjatë drejtimit të automjetit. Disa veçori mund të bllokohen kur automjeti është në marsh. Jo të gjitha veçoritë janë të përputhshme me të gjithë telefonat.

Tregohet pjesa e brendshme e "EcoSport Active" me sedilje të përparme me ngrohje (opsion), timon me ngrohje (opsion) dhe xham të përparmë me ngrohje (opsion).



SYNC



1 EKSPLORONI

I LIDHUR DHE NË KONTROLL

FORD SYNC 3

"Ford SYNC 3" i disponueshëm integrohet në mënyrë të përsosur me celularin tuaj inteligjent për ta bërë komunikimin dhe navigimin të pamundimshëm*. Mund të kontrolloni me "AppLink" aplikacionet e përputhshme me "SYNC", ndërsa "Apple CarPlay" dhe "Android Auto" ju mundësojnë të përdorni ekranin me prekje dhe me ngjyra 8" (20,3 cm) si të ishte celulari juaj inteligjent. Duke përdorur ekranin me prekje apo komanda të thjeshta zanore, mund të bëni telefonata, të shkruani dhe të dëgjoni mesazhe me tekst, si dhe të kontrolloni muzikën dhe navigimin satelitor.

FORDPASS CONNECT

"EcoSports" e pajisur me "FordPass Connect" mundëson një gamë veçorish të projektuara për ta bërë përvojën e drejtimit më të lehtë dhe më të këndshme**. Këto përfshijë "Live Traffic"†, i cili ofron informacione të përditësuara për trafikun në sistemin e navigimit "SYNC 3", dhe "Informacionin për rreziqet lokale"††, i cili mund t'ju paralajmërojë për rreziqe të mundshme gjatë rrugës. Në rast aksidenti, "Ndihma e emergjencës"†‡ i ndihmon pasagjerët të telefonojnë shërbimet e emergjencës për vendndodhjen e automjetit.

APLIKACIONI "FORDPASS"

Përfitoni më shumë nga përvoja me makinën e lidhur me aplikacionin "FordPass"®, me veçori inteligjente në distancë, aplikacioni "FordPass" ju lejon të keni akses te më shumë funksione nëpërmjet celularit tuaj inteligjent. Për të qenë të sigurt, mund ta kyçni ose shkyçni automjetin tuaj kudo që ndodheni, si dhe të shkrini xhamin e përparmë dhe të aktivizoni sediljet dhe timonin me ngrohje (sipas rastit) në një mëngjes dimri të ftohtë. (Disponohet vetëm në tregjet e BE-së.)

Lidhni "EcoSport" me "FordPass".

Vini re: Integrimi i plotë i celularit inteligjent me "SYNC 3" disponohet vetëm me "iPhone 5/Android 5.0 (Lollipop)" e lart. 100% i lidhur. Vetëm për "AppLink" zbatohen tarifa. Për të verifikuar disponueshmërinë e "Apple CarPlay" dhe "Android Auto" në tregun tuaj, shihni faqet zyrtare të internetit të "Apple CarPlay" dhe "Android Auto" për informacionet më të reja. Përditësimet e hartave ofrohen falas për një kohë të kufizuar pas regjistrimit të automjetit.

*Mos e drejtoni automjetin kur jeni të shpërqëndruar. Përdorni sisteme operimi zanore kur është e mundur; mos përdorni pajisje dore gjatë drejtimit të automjetit. Disa veçori mund të bllokohen kur automjeti është në marsh. Jo të gjitha veçoritë janë të përputhshme me të gjithë telefonat.

**Modemi në bord do të lidhet në momentin e dërgimit të automjetit. Mund të zgjidhni nëse doni t'i ndani ose jo disa prej të dhënave. Aty ku disponohet, veçoritë në distancë të "FordPass Connect" janë falas për 10 vjet; më pas, mund të aplikohet një abonim me pagesë.

†Aksesi në "Live Traffic" është falas për 12 muajt e parë pas regjistrimit të një "Ford" të ri me "SYNC 3" me navigim; më pas kërkohet një abonim licence.

††Informacioni për rreziqet lokale është falas për 12 muajt e parë pas blerjes së një "Ford" të ri me module të caktuara informacioni për drejtuesin; më pas kërkohet një abonim licence.

†Ndihma e emergjencës e "Ford" është veçori novatore e "SYNC" që përdor një celular të lidhur dhe të çiftuar me "Bluetooth®" për t'i ndihmuar pasagjerët në makinë të telefonojnë drejtpërdrejt qendrën lokale të komunikimeve në rast përplasjeje të automjetit që shkakton aktivizimin e një airbag-u ose fikjen e pompës së karburantit. Veçoria funksionon në mbi 40 rajone dhe shtete evropiane.

®Aplikacioni "FordPass", i përputhshëm me platformat e caktuara celulari inteligjent është i disponueshëm nëpërmjet shkarkimit. Mund të aplikohen tarifa për mesazhet dhe të dhënat celulare.

ME "B&O" DUKET SI TRANSMETIM DREJTPËRDREJT


SISTEM ZËRI "B&O"

Pavarësisht shijeve tuaja muzikore, që nga këngët klasike te himnet moderne, çdo muzikë meriton të transmetohet sipas mënyrës së synuar nga artisti. Sistemi i audios 675 vat i "Ford", me 10 altoparantë nga "B&O" mundëson pikërisht këtë.

I projektuar dhe i sintonizuar ekskluzivisht për "EcoSport" nga inxhinierët ekspertë të akustikës së "Bang & Olufsen", ai e çon përvojën e çdo udhëtimi në një nivel tjetër. Gjithashtu, dizajnet dalluese të altoparantëve plotësojnë në mënyrë të përkryer pjesën e brendshme me stil të "EcoSport".

- Kalibrim zëri specifik për modelin
- Sistem cilësor zëri me 10 altoparantë
- Bas me zë të dyfishtë
- Zë rrethues
- Fuqi 675 W në dalje
- Dizajn unik i "B&O"

Tregohet "EcoSport Titanium" me një ngjyrë metalike trupi "Solar Silver" (opcion).



DILNI NGA RUTINA

ECOSPORT ACTIVE

Largohuni nga gjithçka me stil dhe komoditet me "EcoSport Active". Shkrijra e dizajnit të frymëzuar nga SUV-të me teknologji të avancuar ofron një kabinë rezistente, por të sofistikuar. Në pjesën e brendshme do të gjeni sedilje të personalizuar me tegela me kontrast. Materialet rezistente ju garantojnë që ajo është gati për udhëtimet në rrugët më të vështira. Me veçori tërheqëse, si p.sh. çatia me ngjyra me kontrast dhe kasat e pasqyrave të dyerve, veshja unike e harkut të rrotave dhe disqet e aliazhit 17" 5-shkallëshe "Shadow Black" ju bëjnë të spikasni, kudo ku ju çon rruga.



Tregohet "EcoSport Active" me ekranin me prekje me ngjyra 8" (20,3 cm) (standard) dhe pasqyrën për shikim pas me errësim automatik (standard).





1 EKSPLORONI

STILUAR PËR SPORT

ECOSPORT ST-LINE

"ST-Line" ofron të gjithë prakticitetin dinamik të "Ford EcoSport", plus stilin tërheqës të frymëzuar nga sportet. Parakolpi, prapakolpi dhe profilet anësore unike të "ST-Line", disqet e aliazhit "Dark Tarnish", pjesa e jashtme e markës "ST-Line", plus çatia opsionale me ngjyra me kontrast dhe krahu i pasmë aerodinamik opsional – të gjitha kontribuojnë në kombinimin unik të përdorshmërisë dhe pamjes tërheqëse të makinës.

Ky imazh me stil të veçantë pasqyrohet përmes pjesës së brendshme të "ST-Line" – me timonin e tij unik me lëkure të cilësisë së lartë "Sensico®" për "ST-Line", levën e marsheve në ngjyrë "Satin Chrome" dhe tapetet e dyshemesë përpara me logon "ST-Line" dhe tegelat me kontrast në "Red", të cilat së bashku theksojnë karakterin sportiv të dizajnit të tij.

Tregohet "EcoSport ST-Line" me disqe aliazhi me shumë shkëlqim 18" 5-shkallëshe në "Shadow Black" (opsion) dhe ngjyrë trupi me veshje të tejdukshme me nuancë "Fantastic Red" (opsion).

1 EKSPLORONI

NDIHMA PARA PËRPLASJES

Nëse ndihma para përplasjes²²⁾ dikton përpara një objekt që nuk lëviz ose që lëviz ngadalë, ajo shfaq fillimisht një paralajmërim dhe më pas lëshon një tingull. Nëse nuk reagoni në drejtim ose nuk frenoni, sistemi do të përdorë automatikisht frenat për të pakësuar ashpërsinë dhe, në disa raste, për të eliminuar përplasjet ballore. (Standard)



ÇENGEL I ÇMONTUESHËM RIMORKIMI

Për më shumë kapacitetet transportimi dhe magazinimi, çengeli i rimorkimit mund të tërheqë deri në 1100 kg* në varësi të motorit. Çengeli i rimorkimit mund të çmontohet nëse nuk përdoret. (Opsion dhe pjesë shtesë)

²²⁾Përdor sensorë. ²¹⁾Veçori e ndihmës për shoferin.

Vini re Veçoritë e ndihmës për shoferin janë funksione shtesë dhe nuk zëvendësojnë vëmendjen e shoferit, gjykimin e tij dhe nevojën për të kontrolluar automjetin.

Lart: Tregohet "EcoSport ST-Line" në ngjyrë trupi me veshje të tejdukshme me nuançë "Fantastic Red" (opsion);

Poshtë: "EcoSport Titanium" në ngjyrë të njëjtë trupi "Frozen White" (opsion). Automjeti i treguar përfaqëson pjesë shtesë që disponohen me çmim shtesë.



SENSORË PËR DISTANCËN E PARKIMIT, PËRPARA DHE PAS

Me "Ford EcoSport" nuk keni pse iu shmangeni hapësirave të vështira të parkimit. Për parkim dhe manovrim më të lehtë, një paralajmërim akustik ju ndihmon të gjykoni distancën ndërmjet makinës tuaj dhe pengesave prapa. (Opsion)

*Kapaciteti maksimal i rimorkimit ndryshon në bazë të ngarkesës, konfigurimit të automjetit, pjesëve shtesë dhe numrit të pasagjerëve.

Poshtë: "EcoSport Active" në ngjyrë metalike trupi "Luxe Yellow" (opsion) me çati me kontrast në ngjyrë "Agate Black".

1 EKSPLORONI

NJOHJE TË SHENJAVE TË QARKULLIMIT

Njohja e shenjave të qarkullimit⁰²⁾ mund të identifikojë shenjat e përhershme ose të përkohshme në anë të rrugës ose sipër saj. Ikona përkatëse do të shfaqet në panelin e instrumenteve për t'ju paralajmëruar. (Standard)



XHAM I PËRPARMË ME NGROHJE "QUICKCLEAR"

Për të larguar ngricën dhe kondensimin nga xhami edhe në mëngjeset më të ftohta, është projektuar një element me ngrohje i integruar në xhamin e përparmë. (Opsion)



⁰⁾Përdor sensorë. ²⁾Veçori e ndihmës për shoferin.

Vini re Veçoritë e ndihmës për shoferin janë funksione shtesë dhe nuk zëvendësojnë vëmendjen e shoferit, gjykimin e tij dhe nevojën për të kontrolluar automjetin.

Lart: "EcoSport ST-Line" në ngjyrë trupi me veshje të tejdukshme me nuancë "Fantastic Red" (opsion); Poshtë: "EcoSport Titanium" në ngjyrë trupi "Desert Island Blue" (opsion).



SISTEMI I INFORMIMIT PËR PIKAT E VDEKURA TË SHIKIMIT ME SINJALIZIMIN PËR TRAFIKUN NË KRYQËZIM

Sistemi i informimit për pikat e vdekura të shikimit⁰²⁾ do t'ju sinjalizojë nëpërmjet dritave të fshehura paralajmëruese të integruara në pasqyrat e derës së shoferit dhe pasagjerit kur dikton një automjet tjetër - makinë, furgon apo kamion - në pikën tuaj të vdekur të shikimit gjatë drejtimit. Po ashtu, sinjalizimi për trafikun në kryqëzim⁰²⁾ ju paralajmëron nëse diktohet një rrezik në lëvizje, ndërkohë që dilni mbrapsht nga një hapësirë pingule parkimi. (Opsion)



⁰⁾Përdor sensorë. ²⁾Veçori e ndihmës për shoferin.

Vini re Veçoritë e ndihmës për shoferin janë funksione shtesë dhe nuk zëvendësojnë vëmendjen e shoferit, gjykimin e tij dhe nevojën për të kontrolluar automjetin.

2

ZGJIDHNI

ZGJIDHNI "ECOSPORT" TUAJ

SHPREHNI INDIVIDUALITETIN TUAJ

Në të gjithë gamën "EcoSport" do të gjeni një zgjedhje gjithëpërfshirëse serish, secila me personalitetet e veta dalluese.

Zgjidhni nga modelet e disponueshme "EcoSport" me teknologjitë e tyre të integruara mbresëlënëse, gamën gjithëpërfshirëse të motorëve dhe dinamikën shpërblyese të drejtimit. Ndryshe, zgjidhni modelin e ndërmjetëm aventurier "Active", i cili dallohet për linjat rezistente sportive dhe karakterin e sigurt dhe të shkathët.

Për nivelin më të lartë të luksit e rafinimit, "Titanium" kombinon stilin bashkëkohor dhe veçoritë e sofistikuara. Ndërsa për një përvojë mbresëlënëse të frymëzuar nga performanca, "ST-Line" bie menjëherë në sy me stilin e saj unik dhe pamjen sportive dhe emotive.



TITANIUM



ST-LINE



ACTIVE

2 ZGJIDHNI

Titanium

Karakteristikat e jashtme

- Disqe aliazhi 17" 10-shkallëshe me lustrim në "Shadow Silver"
- Shufra dhe rrethim të grilës së përparme me lustrim në "Chrome"
- Shina çatie me lustrim në "Black"
- Fshirëse xhami me sensorë shiu, me pasqyrë për shikim pas me errësim automatik
- Drita të përparme kundër mjegullës në ngjyrën e trupit
- Sensorë të pasmë të distancës së parkimit
- Fenerë automatikë

Karakteristikat e brendshme

- Ekran TFT 4,2" (10,6 cm) me ngjyra i panelit të instrumenteve
- Kontroll automatik elektronik i temperaturës (EATC)
- Ndriçim i ambientit
- Sedilje e shoferit me mbështetëse të rregullueshme për mesin

Motori

Benzinë

"Ford EcoBoost" 1,0 L (125 PS/92 kW)



2 ZGJIDHNI

ST-Line

Karakteristikat e jashtme kryesore shtesë të "Titanium"

- Disqe aliazhi 17" 5-shkallëshe me lustrim në "Dark Tarnish"
- Parakolp, prapakolp dhe profile anësore unike të "ST-Line"
- Suspension sportiv
- Xham i pasmë i errësuar
- Drita të pasme sportive halogjene
- Shufra dhe rrethim të grilës së përparme me shumë shkëlqim në ngjyrë "Ebony Black"
- Fole fenerësh në "Black"

Karakteristikat e brendshme kryesore shtesë të "Titanium"

- Timon me "Sensico®" të cilësisë së lartë i qepur me dorë me elemente zbukurimi në "Chrome" dhe tegela "Red"
- Tapete dyshemeje përpara me logon "ST-Line" dhe me tegela "Red"
- Frenë dore e mbështjellë me "Sensico®" të cilësisë së lartë me tegela "Red"
- Levë marshesh e mbështjellë me "Sensico®" të cilësisë së lartë me ekran të zi, model në ngjyrë të kuqe të numrave të marsheve dhe unazë alumini

Motorët

Benzinë

"Ford EcoBoost" 1,0 L (125 PS/92 kW)
"Ford EcoBoost" 1,0 L (140 PS/103 kW)



Active

Karakteristikat e jashtme kryesore shtesë të "Titanium"

- Disqe aliazhi 17" 5-shkallësh "Shadow Black" me shumë shkëlqim të prodhuara nga makineri
- Xham i pasmë i errësuar
- Çatia me ngjyra me kontrast dhe kasat e pasqyrave të dyerve në "Agate Black"
- Veshja unike e harkut të rrotave
- Drita të pasme sportive halogjene
- Shina çatie me lustrim në "Black"

Karakteristikat e brendshme kryesore shtesë të "Titanium"

- Tapete dyshemeje të përparme të cilësisë së lartë me tegela "Grey"

Motorët

Benzinë

"Ford EcoBoost" 1,0 L (125 PS/92 kW)



Paketa e dimrit

Paketa përmban

- Sedilje të përparme me ngrohje
- Timon me ngrohje
- Xham i përparmë me ngrohje "Quickclear"



Paketë e ndihmës për shoferin

Paketa përmban

- Sinjalizues për shoferin
- Sensorë për distancën e parkimit, përpara dhe pas
- Kamerë për shikim pas
- Sistemi i informimit për pikat e vdekura të shikimit me sinjalizues për trafikun në kryqëzim dhe drita të gjata automatike



Paketë-X

Paketa përmban

- Pasqyra dyerësh të palosshme me funksionim elektrik dhe me ngrohje, me sinjale anësore të integruara dhe drita të poshtme
- Xham i pasmë i errësuar
- Sistem "Ford KeyFree" me butonin e ndezjes "Ford Power"
- Navigimi "Ford SYNC 3" me ekran me prekje 8" (20,3 cm), radio DAB, "Apple CarPlay" dhe "Android Auto", lidhje me USB, sistem zëri "B&O", 10 altoparlantë dhe "FordPass Connect" (modemi në bord)



Paketë e përmirësimit të "ST-Line"

Paketa përmban

- Krah i pasmë aerodinamik
- Disqe aliazhi 18" 5-shkallëshe në ngjyrë "Shadow black" me shumë shkëlqim, me goma 215/45 R18



3

PERSONALIZONI

Zgjidhni ngjyrën, disqet, opsionet dhe pjesët shtesë dhe bëjeni "EcoSport" unike për stilin tuaj.



Luxe Yellow

Ngjyrë metalike trupi*

JETA NË NGJYRË MADHËSHTORE

"EcoSport" e gëzon pamjen e jashtme të bukur dhe rezistente nga një proces i veçantë lyerjeje me shumë faza. Nga pjesët e çelikut të trupit të injektuara me dyllë deri në veshjen mbrojtëse të sipërme, materialet e reja dhe proceset e aplikimit garantojnë se "EcoSport" juaj do ta ruajë pamjen e bukur për shumë vite të tjera.

NGJYRAT E TRUPIT



Blazer Blue

Ngjyrë e njëjtë trupi†



Agate Black

Ngjyrë metalike trupi*†



Solar Silver

Ngjyrë metalike trupi*



Frozen White

Ngjyrë e njëjtë trupi*



Desert Island Blue

Ngjyrë metalike trupi*



Fantastic Red

Ngjyrë trupi me veshje të tejdukshme me nuancë*



Grey Matter

Ngjyrë e njëjtë trupi*°



Magnetic

Ngjyrë metalike trupi*†

*Me çmim shtesë.

°Disponohet vetëm në "ST-Line" dhe "Active".

†Nuk disponohet në "Active".

"Ford EcoSport" mbulohet nga garancia për gërryerje e "Ford" për 12 vjet nga data e regjistrimit të tij të parë. Në varësi të kushteve të përgjithshme.

Vini re Figurat e përdorura të makinave shërbejnë vetëm për të ilustruar ngjyrat e trupit dhe mund të mos reflektojnë specifikimet aktuale ose disponueshmërinë e produktit në disa tregje. Ngjyrat dhe zbukurimet që tregohen në këtë broshurë mund të ndryshojnë nga ngjyrat konkrete për shkak të kufizimeve në procesin e përdorur të printimit.



Pjesë e përparme sediljeje "Groove" në ngjyrë "Ebony Black" me zbulurime të pjesshme me "Sensico®", me jastëk sediljeje me zbulurime "Salerno" dhe pjesërisht me "Sensico®" në "Ebony Black"
Standard në "Titanium"



Pjesë e përparme sediljeje "Neosuede" në "Ebony Black", me jastëk sediljeje me "Salerno" e "Sensico®" në "Ebony Black" me tegela "Red"
Standard në "ST-Line"



Pjesë e përparme sediljeje me lëkurë "Salerno"/"Sensico®" në "Ebony Black", me jastëk sediljeje me lëkurë "Salerno"/pjesërisht "Sensico®" në "Ebony Black" me tegela "Blue"
Standard në "Active"



17"
Disk aliazhi 10-shkallësh në "Shadow Silver"
Standard në "Titanium"



17"
Disk aliazhi 5-shkallësh në "Dark Tarnish"
Standard në "ST-Line"



17"
Disk aliazhi 5-shkallësh në "Shadow Black" me shumë shkëlqim
Standard në "Active"



18"
Disk aliazhi 5-shkallësh në "Shadow Black" me shumë shkëlqim
Opsion në "ST-Line"

Vini re "Sensico®" është markë tregtare e "Ford EU" për veshje sintetike të cilësisë së lartë të zhvilluara për pjesët e brendshme të automjeteve. Si veshje vegane, ajo kombinon ndjesinë e cilësisë së lartë dhe butësisë, është rezistente dhe ka pamje të shkëlqyer. Praktike për t'u mirëmbajtur, ajo është e lehtë për t'u pastruar dhe e mbrojtur nga njollat dhe aromat e pakëndshme. Me paraqitje të cilësisë së lartë, "Sensico®" është i shkëlqyer jo vetëm për t'u ulur në mënyrë komode gjatë një udhëtimi të gjatë, por mundëson edhe një ndërgjegjëje të pastër pasi nuk përdor lëkura kafshësh. Është dizajni i sigurt për drejtuesit modernë dhe ambiciozë të makinave.

Vini re Të gjitha disqet e aliazhit disponohen si pjesë shtesë nëpërmjet shitësit tuaj të "Ford", me çmim shtesë. Vizitoni ford-accessories.com

3 PERSONALIZONI PJESËT SHITESË



1.



2.




3.



4.



5.



6.



7.



8.



9.

1. Mbrojtës prapakolpi
2. Kontroll për distancën e parkimit "Xvision (SCC)"*
3. Pllakë e hapësirës së ngarkesës
4. Transportues në çati për biçikletë "Thule®"*
5. Shufra të kryqëzuara çatie
6. Pedale sportive
7. Kamerë e kruskotit "Ford"
8. Çengel i çmontueshëm rimorkimi
9. Tapete dysHEMEJE për të gjitha kushtet e motit
10. Kuti çatie "G3"*
11. Mbrojtëse kundër baltës
12. Mbrojtëse kundër erës "ClimAir®"*

*Artikull që mbulohet nga garancia e ofruesit palë e tretë; shihni kapakun e pasmë për informacione të mëtejshme.

Për më shumë pjesë shtesë të "EcoSport" vizitoni **ford-accessories.com**

Artikujt tregtarë të markës "Ford" mund të blihen në **fordlifestylecollection.com**




4

SPECIFIKIMET

Njihuni me "Ford EcoSport" të ri nga brenda dhe jashtë, që nga teknologjia inteligjente e motorit deri te nivelet e bollshme të pajisjeve.

Ford EcoSport

Disponohet me gamën e "Ford EcoBoost" me motor me benzinë dhe me rrota të përparme aktive



1 Auto Start-Stop

Mund të fikë automatikisht motorin kur ju ndaloni, ndërsa vazhdon të furnizojë me energji pjesët thelbësore, si p.sh. fenerët dhe ajrin e kondicionuar. Rinis automatikisht motorin kur jeni gati për të lëvizur sërish. (Standard)

2 Drejtimi dhe manovrimi

"EcoSport" vazhdon të ofrojë drejtim dhe manovrim të sintonizuar specifikisht për klientët në Evropë, me susta, amortizatorë, mekanizëm të sistemit të drejtimit, shufër kundër spërdredhjes në aksin e pasmë, si dhe cilësime të kontrollit elektronik të qëndrueshmërisë.

3 Ulja

Pozicioni i përmirësuar i uljes në "EcoSport" ju ndihmon të jeni në kontroll të komandave, ndërsa dizajnet e sediljeve janë optimizuar për komoditet të shtuar të pasagjerëve në pjesën e përparme dhe të pasme.

4 Motorët "Ford EcoBoost"

Motori me benzinë 1,0 litërsh "EcoBoost" i "Ford" që ka fituar disa çmime është i disponueshëm në versionet 140 PS (103 kW), 125 PS (92 kW) dhe 100 PS (74 kW), ku secila funksionon nëpërmjet një transmisioni manual me gjashtë marshe.

PERFORMANCE



Sedilje të pasme të ndara e të palosshme në mënyra të ndryshme

Palosni sediljet e pasme me ndarje 60:40 dhe përftoni një hapësirë të pasme prej 1238 litrash.

4 SPECIFIKIMET MOTORËT

I PROJEKTUAR PËR TË KURSYER

"EcoSport" është i disponueshëm me një version 140 PS (103 kW) ose 125 PS (92 kW) të motorit me benzinë 1,0 litërsh "EcoBoost" i "Ford" që ka fituar disa çmime, i cili ofron efikasitet karburanti 5,4 L/100 km* dhe 121 g/km* emetime të CO₂. Ofrohet gjithashtu versioni 100 PS (74 kW), i cili arrin një konsum të kombinuar karburanti prej 5,3 L/100 km* dhe emetime të CO₂ prej vetëm 120 g/km*. Të gjitha versionet funksionojnë nëpërmjet një transmisioni manual me gjashtë marshe me ndërrim të qetë.

Për informacion të mëtejshëm rreth efikasitetit të karburantit dhe emetimeve, shihni tabelat e specifikimeve.

*Standardi "NEDC CO₂MPAS" sipas shifrave të testeve zyrtare. Konsumi real i karburantit mund të ndryshojë. Shihni seksionin "Karburanti dhe performanca" për më shumë informacion.



Karburanti, performanca dhe emetimet

	1.0L Ford EcoBoost 125 PS (82 kW) (me "Auto Start-Stop")	1.0L Ford EcoBoost 140 PS (103 kW) (me "Auto Start-Stop")
Emetimet e CO ₂ ^{oo} (g/km) – WLTP i përgjithshëm	151-134	151-134
Konsumi i karburantit ^{oo} në L/100 km – WLTP i përgjithshëm	6,6-5,9	6,6-5,9
5 dyer		
Standardi i emetimeve	Euro 6d-TEMP	Euro 6d-TEMP
Transmisioni	Me 6 marshe manuale	Me 6 marshe manuale
Drejtimi	4x2	4x2
Fuqia maksimale PS (kW)	125 PS (82 kW)	140 PS (103 kW)
Forca rrotulluese Nm (Nm me mbingarkim)	170 Nm (200 Nm)	180 Nm (200 Nm)
Performanca ^a		
Shpejtësia maksimale (km/orë)	180	186
0-100 km/orë (sekonda)	11.0	10.2
50-100 km/orë* (sekonda)	10.5	10.3
Peshat dhe ngarkesat		
Pesha neto (kg)*	1347	1347
Masa bruto e automjetit (kg)	1730	1730
Masa bruto e mjetit me rimorkio (kg)	2630	2630
Masa maks. që tërhiqet (me frena) (kg)	900	900
Masa maks. që tërhiqet (pa frena) (kg)	670	675

*Në marshin e 4-t. ^aShifra të testeve të "Ford". **DPF** = filtri i grimcave të naftës. "BP Ultimate" mund të rrisë fuqinë dhe përsheptimin, të ulë emetimet e sistemit të shkarkimit dhe të përmirësojë kursimin e karburantit, në krahasim me karburantet e zakonshme.
^{oo}Konsumet e deklaruar të karburantit/energjisë, emetimet e CO₂dhe diapazonet elektrike përcaktohen në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike të rregulloreve evropiane (KE) 715/2007 dhe (BE) 2017/1151 të ndryshuara së fundmi. Procedurat standarde të zbatuara të testimit mundësojnë krahasimin ndërmjet llojeve të ndryshme të automjeteve dhe prodhuesve të ndryshëm.
Përveç efikasitetit të karburantit/energjisë të makinës, në përcaktimin e konsumit të karburantit/energjisë së makinës, në emetimet e CO₂ dhe në diapazonin e energjisë luajnë rol mënyra e drejtimit dhe faktorë të tjerë joteknikë. CO₂ është gazi kryesor me efekt serrë përgjegjës për ngrohjen globale. Udhëzuesi për kursimin e karburantit dhe emetimet e CO₂ që përmban të dhëna për të gjitha modelet e reja të automjeteve për pasagjerë disponohet falas në çdo pikë shitjeje.
[#]Përfaqëson peshën më të vogël neto, duke supozuar një shofer me peshë 75 kg, nivele të plota të lëngjeve dhe nivele karburanti 90%, në varësi të tolerancave dhe opsioneve të prodhimit etj. me të cilat është pajisur. Performanca dhe kursimi tek të gjitha modelet ulen kur automjetet përdoren për rimorkim. Kufiri i peshës së ngarkesës në çati është maksimumi 40 kg në të gjitha modelet.

4 SPECIFIKIMET PËRMASAT

Dimensionet

Gjatësia e përgjithshme pa gomë rezervë (mm)	4096
Gjerësia e përgjithshme me pasqyra/me pasqyra të palosura/pa pasqyra (mm)	2057/1816/1765
Lartësia e përgjithshme (pa ngarkesë) me/pa shina çatie (mm)	1713/1653
Niveli i këndit të afrimit (automjet pa ngarkesë)	21,0°
Këndi i nisjes (automjet pa ngarkesë)	33,3°
Lartësia e platformës nga toka (automjet pa ngarkesë)	23,3°
Distanca nga toka pa ngarkesë/me ngarkesë të plotë	(160/137 me naftë) (190/164 me benzinë)
Rrethi i kthesës – cep më cep (m)	10.6
Gjatësia midis akseve	2519
Distanca midis rrotave përpara (min. maks. (në varësi të shkarjes së rrotave))	1530
Distanca midis rrotave pas (min. maks. (në varësi të shkarjes së rrotave))	1522
Kapaciteti i bagazhit (litra)*	
Varianti me 5 sedilje (ngarkuar në dyshemenë e bagazhit)	356
Varianti me 5 sedilje (gama, në varësi të këndit të sediljeve të pasme) (ngarkuar në dyshemenë e bagazhit)	334
Varianti me 2 sedilje (ngarkuar në çati)	1238
Dimensionet e hapësirës së bagazhit	
Lartësia maks. e hyrjes në hapësirën e ngarkesës	881
Gjerësia maks. e hyrjes në hapësirën e ngarkesës	1022
Lartësia maks. e ngarkesës (deri te çatia/mbulesa e bagazhit)	1010/605

Gjerësia e ngarkesës midis foleve të rrotave	950
Gjatësia e ngarkesës në dysheme deri në rreshtin e dytë	691
Gjatësia e ngarkesës deri në rreshtin e parë (sediljet e rreshtit të dytë të palosura)	1369 mm në 15,8°
Ngritja mbi lartësinë në gjendje peshe neto (pa ngarkesë)	627
Kapaciteti i serbatorit të karburantit (litra)	
Benzinë	52
Naftë	52
Pjesa e brendshme, rreshti i parë	
Hapësira mbi kokë (pa baxhë)	1008
Hapësira për këmbët (maksimumi me sediljen në pozicionin e lartësisë mesatare prapa)	1116
Hapësira për shpatullat	1355
Pjesa e brendshme, rreshti i 2-të	
Hapësira për kokën	971
Hapësira për këmbët (nominale me sediljen përpara në pozicion SAE 95%)	933
Hapësira për shpatullat	1302

*Matur në përputhje me ISO 3832.
Dimensionet mund të ndryshojnë në varësi të modelit dhe të pajisjeve të montuara.



Ngjyra dhe zbukurimet

	Ngjyra të njëjta trupi			Ngjyra metalike trupi*					Ngjyra të veçanta metalike trupi*
	Frozen White	Grey Matter	Blazer Blue	Solar Silver	Luxe Yellow	Magnetic	Agate Black	Desert Island Blue	Fantastic Red
Titanium (standard)									
Zbukurimi dhe ngjyra e pjesës së përparme të sediljeve: "Groove Sensico®" në "Ebony Black"	☐		☒	☐	☐	☐	☐	☐	☐
Zbukurimi dhe ngjyra e pjesës së poshtme të sediljeve: "Salerno Sensico®" në "Ebony Black"									
Ngjyra e panelit të sipërm dhe të poshtëm të instrumenteve: Ebony Black									
ST-Line (standard)									
Zbukurimi dhe ngjyra e pjesës së përparme të sediljeve: "Neosuede" në "Ebony Black"	☐	☐	☒	☐	☐	☐	☐	☐	☐
Zbukurimi dhe ngjyra e pjesës së poshtme të sediljeve: "Salerno Sensico®" në "Ebony Black" me tegel të kuq									
Ngjyra e panelit të sipërm dhe të poshtëm të instrumenteve: Ebony Black									
Active (standard)									
Zbukurimi dhe ngjyra e pjesës së përparme të sediljeve: "Salerno Sensico®" në "Ebony Black"	☒	☐		☐	☐			☐	☐
Zbukurimi dhe ngjyra e pjesës së poshtme të sediljeve: Miniperforim "Salerno Sensico®" në "Ebony Black" me tegel blu									
Ngjyra e panelit të sipërm dhe të poshtëm të instrumenteve: Ebony Black									

Kombinimet e ngjyrave të trupit dhe çatisë në ty tonalitete

	Ngjyra të njëjta trupi			Ngjyra metalike trupi*					Ngjyra të veçanta metalike trupi*
	Frozen White	Grey Matter	Blazer Blue	Solar Silver	Luxe Yellow	Magnetic	Agate Black	Desert Island Blue	Fantastic Red
Ngjyra e çatisë									
ST-Line									
Agate Black	☒	☒		☒	☒	☒	☒	☒	☒
Active									
Agate Black	☒	☒		☒	☒		☒	☒	☒

*Opsione me çmim shtesë.

- ☒ Standard
- ☐ Optional, me çmim shtesë
- ☒ Disponohet

PËR MË SHUMË INFORMACION MBI FAMILJEN "FORD SUV", VIZITONI WWW.FORD.COM



Figurat, përshkrimet dhe specifikimet. Kjo broshurë ka qenë e saktë në kohën e printimit. Megjithatë, politika e Ford-it synon drejt zhvillimit të vazhdueshëm të produktit. E drejta i rezervohet ndryshimit të specifikimeve, ngjyrave dhe çmimeve të modeleve dhe artikujve të ilustruar dhe të përshkruar në çfarëdo kohe në këtë botim. Për të dhënat më të fundit, këshillohuni gjithmonë me shitësin e Ford-it. **Pajisje fakultative.** Kudo në këtë botim, sa herë që një karakteristikë përshkruhet si një "Opsion" ose "Pajisje/Paketë Fakultative", etj., ju duhet të supozoni se ajo do të jetë me çmim shtesë kundrejt modelit bazë, përveçse kur deklarohet ndryshe. Të gjithë modelët dhe kombinimet e ngjyrave varen nga disponueshmëria. **Shënim.** Disa nga figurat janë të një modeli para prodhimit dhe/ose të krijuara me kompjuter, prandaj konstruksioni/funksionet në versionin final të automjetit mund të jenë të tjera në raste të ndryshme. Gjithashtu, disa nga karakteristikat e treguara në automjete mund të jenë fakultative. **Shënim.** Kjo broshurë përmban si aksesore origjinale të Ford-it, ashtu dhe një gamë produktesh nga furnizuesit tanë. Vendorsja e aksesoreve shtesë, mund të ketë ndikim në konsumin e karburantit të automjetit tuaj. **♣**Aksesorët e identifikuar janë aksesore markash të zgjedhura me kujdes nga furnizues të palës së tretë, të cilat nuk mbulohen nga garancia e Ford-it, por nga garancia e vetë furnizuesit të palës së tretë, të dhënat e të cilit mund t'i merrni te shitësi juaj i Ford-it. Marka e fjalës iPod dhe logot janë pronë e Apple Inc. Markat dhe emrat e tjerë tregtarë janë ato të pronarëve të tyre përkatës. **Shënim.** Disa veçori ndihmëse dhe sigurie për drejtuesin e mjetit të përshkruara në këtë broshurë janë projektuar të funksionojnë duke përdorur sensorë, performanca e të cilëve mund të ndikohet nën kushte të caktuara të motit ose të mjedisit.

Katalogu Botimi Ndërkombëtar është vetëm për informacion të përgjithshëm; specifikimet e bëra nuk kanë lidhje me ndonjë treg të veçantë. Ka mundësi që ilustrimet ose teksti të përmbajnë referenca për modelet, karakteristikat ose kushtet, të cilat nuk janë të disponueshme në disa vende, as si pajisje standarde, as si fakultative. Për më tepër, ato mund të lënë jashtë karakteristika të veçanta që janë të disponueshme. Kështu që, ju lutemi konsultohuni gjithmonë me Shitësin e Ford-it për detajet më të fundit të specifikimeve dhe çmimet aktuale.

Botuar nga "Ford Motor Company Limited",

Laindon, Essex, Angli.

Regjistruar në Angli me nr. 235446

FoE Y63A

0322/EDM al

Mars 2022.

© Ford Motor Company Limited.

MY 2022.25 EDM al



Sub 150 PS
Ford 1.0 litre EcoBoost